



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/58

Datë: 02.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, të nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të "Trepça Sh. A." emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Bahri Hyseni, kryesues;
 - 1.2. Z. Ibrahim Krasniqi, anëtar;
 - 1.3. Z. Muharrem Peci, anëtar;
 - 1.4. Z. Bujar Bilalli, anëtar;
 - 1.5. Z. Xhevdet Tahiri, anëtar.
2. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-120 për Trepçën, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/58
Datë: 02.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 shkurt 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore Korporata Energjetike e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Skender Haziri, kryesues;
 - 1.2. Znj. Merita Kasapolli, anëtare;
 - 1.3. Z. Beza Halilaj, anëtar;
 - 1.4. Znj. Valbona Raifi - Deshishku, anëtare;
 - 1.5. Z. Mustafa Pllana, anëtar;
 - 1.6. Z. Valdrin Krasniqi, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë